



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut  
Opština Kaçanik  
Municipal Kaçanik



REPUBLIKA E KOSOVES  
REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E KAÇANIKUT  
OPŠTINA KAÇANIK



|         |          |         |                 |
|---------|----------|---------|-----------------|
| Data    | 01.02/19 | Vendi   | Kaçanik         |
| Nj. org | 01 Nr.   | Numri   | 60/01-1994/2019 |
|         |          | Shtojce |                 |

**PËR: Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal,  
-Zyrës Ligjore-**

**NGA: Kryesuesi i Kuvendit të Komunës Kaçanik, Kemal Mërseli**

**Lënda: Dërgimi i Vendimeve të mbledhjes së I (Parë) të Rregullt të Kuvendit të Komunës Kaçanik, mbajtur me 29 Janar 2019.**

Bashkëlidhur me këtë Shkresë, u dërgojmë, Vendimet e Kuvendit të Komunës Kaçanik, nga mbledhja e I (Parë) e Rregullt e Kuvendit të Komunës, mbajtur me datë: 29 Janar 2019 dhe atë:

1. Vendim Paraprak për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore të Parcelës Kadastrale Nr. 00144-51 ZK, Kaçanik / Lënda: 01Nr. 06-350/02-1721/19;
2. Vendimi për financimin e shpenzimeve të varrimit për rastet mortore të paraqitura të qytetarët e Komunës së Kaçanikut / Lënda: 01Nr. 104/02-1514/19;
3. Vendimi për ndryshim plotësimin e komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës / Lënda : 01Nr. 104/02-2312/19 ;
4. Vendimi për aprovimin e Planit të Punës së Ekzekutivit të Komunës për vitin 2019/ Lënda : 01Nr. 104/02-1839/19.

Vendimet ua dërgojmë në afatin e përcaktuar ligjor, me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë së tyre nga Zyra Ligjore e MAPL-së.

Me respekt!



Kryesuesi i Kuvendit  
Kemal Mërseli



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut  
Opština Kaçanik  
Municipal Kaçanik

01.Nr. 06-350/02-1721/19  
Kaçanik, 29.01.2019

Në mbështetje të nenit 12.2 (d) lidhur me nenin 14.1 të Ligjit Nr. 03/L-040 - Për Vetëqeverisjen Lokale, të nenit 10.2 dhe 10.3 të Ligjit 02/L-26 –Për Tokën Bujqësore, të nenit 6.2 dhe 8 të Udhëzimit Administrativ Nr. 41/2006 –Për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, të Propozim Vendimit të DUKMM 06 Nr. 350/02-1721/19 – Për Ndërrimin e Destinimit të Tokës Bujqësore në Tokë Ndërtimore të Parcelës Kadastrale Nr. 00144-51 me Kulturë Pyjore, Mal i Klasës së I (Parë) në Zonën Kadastrale, Kaçanik, në vendin e quajtur, Dushkajë, në pronësi të Xhabir Zharku, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e vet të mbajtur me 29 Janar 2019, mori këtë:

### V E N D I M PARAPRAK PËR NDËRRIMIN E DESTINIMIT TË TOKËS

1. Me këtë Vendim, merret Vendim Paraprak -Për ndërrimin e destinimit të Tokës Bujqësore, në Tokë Ndërtimore.
2. Toka me destinim bujqësor e lejuar për ndërrimin e destinimit nga pika 1. e këtij Vendimi, lejohej në parcelën kadastrale **00144-51**, me Kulturë Pyjore-Mal i klasës së I (Parë), me sipërfaqe **765m<sup>2</sup>**, e evidentuar në Certifikatën mbi të drejtat e pronës së paluajtshme me Nr. P-70917048-00144-51 në Zonën Kadastrale Kaçanik, në vendin e quajtur, Dushkajë, në pronësi të Xhabir (Nezir) Zharku, destinohet në tokë ndërtimore.
3. Parcela Kadastrale si në pikën 1 të këtij Vendimi, sipas Planit Zhvillimor Komunal në fuqi parashihet “tokë bujqësore” dhe “digjitalizim i vendbanimeve 2004 dhe zona urbane”, ndërsa me këtë Vendim i ndërrohet destinimi në tokë ndërtimore dhe e njëjta bëhet pjesë përkatëse e PZHK.
4. Kompensimi për ndërrimin e destinimit të tokës së përcaktuar si në pikën 2 të këtij Vendimi, do të paguhet në procedurë administrative, sipas dispozitave nënligjore në fuqi që e përcaktojnë ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore.
5. Para marrjes së vendimit përfundimtar për ndërrimin e destinimit të tokës së përcaktuar si në pikën 2 të këtij Vendimi, do të kërkohet. Pëlqimi nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.
6. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesën: Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit si dhe Drejtoria për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari.
7. Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës – MAPL-së, si dhe 7 ditë pas publikimit në Faqen zyrtare të komunës.

**Me këtë Vendim njoftohen:** Kryetari i Komunës, Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit- përmes kësaj drejtorie njoftohet pala dhe organet tjera relevante, Drejtoria për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari, Drejtoria për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim dhe Arkiva.



Kryesuesi i Kuvendit  
Kemal Mërseli



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



**Komuna Kaçanik**  
Opština  
Kaçanik  
Municipal of Kaçanik

**Drejtoria e Urbanizimit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit**  
06.Nr. 06-350/02-1721/19  
Kaçanik, 18.01.2019

Drejtoria e Urbanizimit, Kadastrit dhe mbrojtjes së Mjedisit e Komunës së Kaçanikut duke u bazuar në nenin 10.5 pika b të Ligjit Nr.02/L-26, për Tokën Bujqësore; në bazë të nenit 6 pika 6.2 të Udhëzimit Administrativ Nr.41/2006, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësor, lidhur me kërkesën 06.Nr. 06-350/02-1721/19 për ndërrim destinimi të tokës bujqësore:

#### **Propozon**

Komiteti për Politikë dhe Financa dhe Kuvendin Komunal, që lidhur me kërkesën e z.Xhabir Zharku nga Kaçaniku për ndërrim destinimi të tokës nga ajo pyjore në atë ndërtimore, të merr:

#### **VENDIM PARAPRAK**

Aprovohet kërkesa 06.Nr. 06-350/02-1721/19 e datës 18.01.2019 e parashtruar nga z.Xhabir Zharku për lejimin e ndërrimit të tokës bujqësore në atë ndërtimore 765m<sup>2</sup>, në parcelën kadastrale nr.P-70917048-00144-51, zona kadastrale Kaçanik, vendi i quajtur Dushkajë, me kulturë Pyjore-mal i klasës 1, me sipërfaqe 765m<sup>2</sup>, pronë e Xhabir Zharku.

#### **Arsyetim**

Në drejtorinë e Urbanizimit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit ka arritur kërkesa me numër 06.Nr. 06-350/02-1721/19 për ndërrimin e destinimit nga toka me kulturë pyjore-mal i klasës 1 në tokë ndërtimore.

Sipas Planit Zhvillimor Komunal në fuqi parashihet “toka bujqësore” dhe “digjitalizim i vendbanimeve 2004 dhe zona urbane”.



Drejtori i drejtorisë  
Ukshin Çallaku



REPUBLIKA E KOSOVËS

## 0101 - Formulari për kërkesë apo ankesë

Drejtorati / Njesia

Urbanizmit, Kadaster dhe Mjedis

Data

18.01.2019

(dita / muaji / viti)

KAGANTKU



## 1 Informatat personale të parashtruesit të kërkesës:

Emri dhe mbiemri

XHABIR ZHARKU

Lloji dhe numri i dokumentit identifikues

Data e lindjes

(dita / muaji / viti)

Adresa e vendbanimit

DUSHKASTE

(numri i shtëpisë/banesës, rruga, fshati/qyteti, kodi postar)

Numri i tel. fiks

Numri i tel. mobil

E-mail adresa

044 842 777

Mos

shkruani në

Pranuar nga:

Numri i protokollit:

06-370/02-

Vendimi: po

Nga:

Data:

## 2 Selektu llojin:

Kërkesë



Ankesë



## 3 Ju lutemi të shkruani kërkesën apo ankesën tuaj në detaje:

Kërkesë nga organi kompetent lejitim  
e motimit të destruktimit për parcel  
nr. 144-51 rreth kadastere KAGANTKE.

## 4 Dëshmia e aplikuesit për vërtetësi

Unë

Zh. Zharku

vërtetoj se informatat e lartshënuara janë të vërteta.

(Emri i plotë i aplikuesit)

(Nënshkrimi)

\*\*\* Ju lutemi të kërkonit nga zyrtari/ja fletëdëshminë për dorëzimin e kësaj kërkesë dhe dokumenteve të bashkangjitura \*\*\*



Republika e Kosovës  
Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

MINISTRIA E MJDITIS DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR /MINISTARSTVO SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA/MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING  
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGJENCIA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

## CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-70917048-00144-51

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number: 941-1709/2019  
Data dhe koha e fshimit / Datum i vrene izdavanja / Date and time of submission: 18.01.2019 - 11:18  
Komuna / Opština / Municipality: Kaçanik / Kačanik / Kaçanik  
Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: KAÇANIK / KAČANIK / KAÇANIK  
Zyra kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastal Office: Kaçanik / Kačanik / Kaçanik

### A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

| Numri i njësise kadastrale<br>Broj katastarske jedinice<br>Cad. Unit. No. | Lloji i njësise<br>Vrsta jedinice<br>Unit Type | Lloji i pronës<br>Vrsta imovine<br>Property Type                      | Zona<br>U/R<br>C/S<br>U/R | Sipërfaqja<br>Površina<br>Area<br>(m <sup>2</sup> ) | Përshkrim<br>Opis<br>Description | Krijuar më datën<br>Uradjeno na dan<br>Created On | Azhuruar<br>Azurirano<br>Updated |
|---------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------|---------------------------|-----------------------------------------------------|----------------------------------|---------------------------------------------------|----------------------------------|
| P-70917048-00144-51                                                       | PARCELË /<br>PARCELA /<br>PARCEL               | Pronë shoqërore /<br>Društvena<br>Imovina /<br>Socially owned<br>Land | Urban                     | 765                                                 | 46-2004; 20-2018                 | 26.11.2018                                        | 26.11.2018                       |

### A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

| Vendbanimi - adresa<br>Prebivaliste - adresa<br>Resident - address | Kodi Postal<br>Poštanski kod<br>Postal Code | Hollësitë e adresës<br>Pojednostni adrese<br>Address Details | Krijuar më datën<br>Uradjeno na dan<br>Created On | Azhuruar<br>Azurirano<br>Updated |
|--------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------|--------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------|----------------------------------|
| DUSHKAJA/DUSHKALA/DUSHKALA                                         |                                             | DUSHKAJA                                                     | 26.11.2018                                        | 26.11.2018                       |



Zyrtari përgjegjës / Official person

# A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSIA KORISCENJA / TYPE OF USE

| Numri<br>Broj<br>Number | Lloji i shfrytëzimit të parcelës<br>Vrsta koriscenja parcele<br>Parcel Type Of Use | Shfrytëzimi aktual i parcelës<br>Trenutno koriscenje parcele<br>Parcel Current Use | Kualiteti i klasës<br>Kvalitet klase<br>Quality Class | Sipërfaqja (m²)<br>Površina (m²)<br>Area (m²) |
|-------------------------|------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------|-----------------------------------------------|
| 1                       | Pyje/shumsko / forestry                                                            | Tokat Pyje/shumsko zemljište/forest                                                | Mial I Klases /Suma 1 Klase/1st Class Forest          | 765                                           |

# B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

| Të drejtat<br>Prava<br>Rights                                         | Emri<br>Ime<br>Name   | Nr. personal<br>Licent broj<br>ID. No. | Vendbanimi<br>Prebivalište<br>Resident | Kodi postar<br>Poštanski kod<br>Postal code | Hollësitë e adresës<br>Pojednosti adrese<br>Address details | Pjesa e pronës<br>Deo inovine<br>Share quota | Pershkrimi<br>Ops.<br>Description | Azhuruar<br>Azurirano<br>Updated |
|-----------------------------------------------------------------------|-----------------------|----------------------------------------|----------------------------------------|---------------------------------------------|-------------------------------------------------------------|----------------------------------------------|-----------------------------------|----------------------------------|
| Poseidim individual /<br>Individualna Druzavina /<br>single possessor | ZHARKU XHABIR (NEZIR) | KCID0900363                            | KAÇANIK / KAÇANIK /<br>KAÇANIK /       |                                             |                                                             | I/I                                          | 46-2004                           | 27.11.2018                       |



# Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosova

Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor /Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja/Ministry of Environment and Spatial Planning


AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

## KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : KAÇANIK

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Kaçanik

| Njësia/Jedinica/Unit | Tipi/Vrsta/Type            | Sipërfaqja/Povšina/Area m2 |
|----------------------|----------------------------|----------------------------|
| P-70917048-00144-51  | Parcelë / Parcela / Parcel | 765.0                      |
| 06-941-4714          |                            |                            |



Shkalla/Razmera/Scale: 1:303

Punoi/Obradio/Created:

Data/ Data/Date: 18.01.2019

Koha/ Vreme/ Time: 11:22:45

Nënshkrimi/Potpis/Siganture:

Shënim/Beleška/Note:



Aprovoi/Usvojila/Approved:

Drejtori/Direktor/Director

Nënshkrim/Potpis/Siganture:



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut  
Opština Kačanik  
Municipality of Kaçanik

01-Nr. 104/02-1514/19  
Kaçanik; 29.01.2019

Në mbështetje të nenit 12, 17 të Ligjit nr. 03/L-040-Për Vetëqeverisjen Lokale ( Gazeta Zyrtare Nr. 28/04 Qershor 2008), nenit 6.2 lidhur me nenin 61 të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e mbajtur me 29 Janar 2019, mori këtë:

**VENDIM**  
**PËR FINANCIMIN E SHPENZIMEVE TË VARRIMIT PËR RASTET MORTORE TË**  
**PARAQITURA TË QYTETARËT E KOMUNËS SË KAÇANIKUT**

1. Me këtë vendim, Lejohet financimi i shpenzimeve të varrimit në shumë **175.00€** për secilin rast mortor të paraqitur të qytetarët e Komunës së Kaçanikut.
2. Financimi në tërësi i shpenzimeve të caktuara të varrimit për të gjitha rastet e paraqitura deri në shumën e cekur në pikën 1. të këtij Vendimi, përfshinë këto shërbime:
  1. Lajmërimi (temxhiti),
  2. Pastrimi dhe ruajtja e kufomës në morg (lokacionet ekzistuese në komunën tonë),
  3. Sigurimi i dërrasave,
  4. Sigurimi i mbështjellësit (qefini),
  5. Ceremonia e faljes së kufomës,
  6. Transporti i kufomës brenda territorit të Republikës së Kosovës,
  7. Piramida (mbishkrimi i emrit dhe mbiemrit).
3. Mjetet buxhetore nga pika 2. të këtij Vendimi do të merren nga kategoria e Mallrave dhe Shërbimeve në kuadër të Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencave.
4. Me këtë Vendim, qytetarët e Komunës së Kaçanikut, nuk lirohen nga pagesa e anëtarësisë ndaj bashkësive fetare.
5. Bashkësitë fetare nuk mund t'i kushtëzojnë qytetarët e Komunës së Kaçanikut, me pagesën e anëtarësisë, për kryerjen e shërbimeve të cekura në pikën 2. të këtij Vendimi.
5. Çmimet për shërbimet nga pika 2 e këtij Vendimi, raportimi për mjetet e shpenzuara si dhe çështje të tjera të cilat nuk janë potencuar me këtë vendim, do të rregullohen me, marrëveshje të Kryetarit të Komunës dhe Bashkësive fetare, e cila marrëveshje do të jetë pjesë përbërës e këtij Vendimi.
6. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencave, ndërsa ekzekutimin financiar do ta bëjë, Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit.
7. Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës – MAPL-së, si dhe 7 ditë pas publikimit në Faqen zyrtare të komunës.

**Me këtë Vendim, njoftohen:** Kryetari i Komunës, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencave, Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit dhe Arkivi



Kryesuesi i Kuvendit  
Këmal Mërseli



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova**  
**Republic of Kosovo**



**Komuna e Kaçanikut**  
**Opština Kačanik**  
**Municipal Kačanik**

01Nr. 104/02-2312/19  
Kaçanik, 29.01.2019

Në bazë të nenit 12 të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale ( Gazeta Zyrtare Nr. 28/04 Qershor 2008) të nenit 8 pika 3. e Ligjit Nr. 04/L-144 për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 35/17 Dhjetor 2012) të Propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës 01Nr. 104/02-2312/19, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e mbajtur me 29 Janar 2019, mori këtë:

### **VENDIM**

**PËR NDRYSHIM PLOTËSIMIN E VENDIMIT TË KUVENDIT TË KOMUNËS  
01Nr. 104/02-8499/18 TË DATËS 30.03.2018- PËR FORMIMIN E KOMISIONIT  
VLERËSUES PËR DHËNIEN NË SHFRYTEZIM TË PRONËS SË PALUAJTSHME  
TË KOMUNËS**

1. Me këtë vendim, Ndryshohet dhe Plotësohet Vendimi i Kuvendit të Komunës 01Nr. 104/02-8499/18 i datës 30 Mars 2018- Për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës.
2. Ndryshim Plotësimet e Vendimit të Kuvendit të Komunës të përcaktuar si në pikën 1 të këtij Vendimi, bëhet të paragrafi 1.6. e pikës 1 e Vendimit, ashtu që:
  - 2.1. Nga Komisioni me Kërkesën e tij, hiqet Zylfi Koxha, anëtar i komisionit nga Ekzekutivi i Komunës.
  - 2.2. Në vend të anëtarit të hequr, caktohet për anëtar të komisionit nga Ekzekutivi i Komunës, Besnik Bajra.
3. Pikët tjera të Vendimit mbesin të pandryshuara.
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit dhe Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit.
5. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës të MAPL, si dhe 7 pas publikimit në Faqen Zyrtare të Komunës.

**Me këtë Vendim njoftohen:**, Kryetari i Komunës, Zylfi Koxha, Besnik Bajra, Komisioni për Dhënie në Shfrytëzim të Pronave Komunale, Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit dhe Arkivi.



Kryesuesi i Kuvendit  
**Kemal Mërseli**



01.Nr 104/02-2312 /19

Kaçanik, 24/01/2019

Kryetari i Komunës së Kaçanikut në bazë të nenit 58, pika h, të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, të nenit 6, pika b dhe h, të Statutit të Komunës së Kaçanikut,

### Propozon

Që Kuvendi i Komunës në bazë të nenit 12. të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, të nenit 8 pika 3. e Ligjit Nr. 04/L-144 për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës, në mbledhjen e datës \_\_\_\_\_ mori këtë:

### VENDIM

#### PËR PLOTËSIMI-NDRYSHIMIN E KOMISIONIT VLERËSUES PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS

1. Me këtë vendim plotësohet-ndryshohet komisioni vlerësues për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës dhe rrjedhimisht plotësohet pika 1.6 e vendimit me nr. të protokollit 01Nr. 104/02-8499/18, të datës 30/03/2018,
2. Hiqet nga komisioni anëtari z. Zylfi Koxha, dhe zëvendësohet me anëtarin z. Besnik Bajra.
3. Ky vendim bëhet i plotfuqishëm me rastin e nënshkrimit të tij.

### Arsyetim

Më datë 23/10/2018, anëtari dhe njëherit kryesuesi i zgjedhur i komisionit të lartpërmendur ka kërkuar me shkrim që të lirohet nga komisioni në fjalë. Në këtë kërkesë, janë dhënë arsyet se për shkak se i lartpërmenduri nuk mund të japë kontributin e duhur në fushën juridike sepse konsideron që në aspektin juridik ndien mangësi në të kuptuarit të ligjeve dhe akteve nënligjore sidomos në interpretimin e tyre. Ne, duke parë rëndësinë që ka ky komision, e kemi aprovuar kërkesën dhe njëherësh kemi propozuar që të zëvendësohet me anëtarin e ri- Besnik Bajra. Bazuar në situatën e krijuar kërkojmë nga anëtarët e Kuvendit Komunal, që të shqyrtojnë dhe të miratojnë këtë plotësim-ndryshim të komisionit.



Kryetari i Komunës

z. Besim Ilazi



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut  
Opština Kačanik  
Municipal Kačanik

01Nr. 104/02-1839/19  
Kaçanik, 29.01.2019

Në bazë të nenit 17 lidhur me nenin 40.2(d) të Ligjit Nr.03/L-040-Për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/04 Qershor 2008), të neneve 2.1, 6.2 dhe 34.5 të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e vet të mbajtur me 29 Janar 2019, merr këtë:

**V E N D I M**  
**PËR APROVIMIN E PLANIT TË PUNËS SË EKZEKUTIVIT TË KOMUNËS**  
**PËR VITIN 2019**

1. Me këtë Vendim, Aprovohet Plani i Punës së Ekzekutivit të Komunës për vitin 2019, i propozuar nga Kryetari i Komunës.
2. Në Planin e Punës së Ekzekutivit të Komunës si në pikën 1 të këtij Vendimi janë paraqitur, synimet dhe objektivat e Kryetarit të Komunës, Drejtorive komunale, dhe forma e realizimit të tyre.
3. Plani i Punës së Ekzekutivit të Komunës përmban numër të protokollit 01Nr. 104/02-1839/19, është përmbledhur në gjithsej, 72 faqe, dhe i njëjti është pjesë përbërëse e këtij Vendimi.
4. Për zbatimin e Planit të Punës të Punës së Ekzekutivit të Komunës për vitin 2019, do të kujdesen: Kryetari i Komunës dhe drejtorët e drejtorive përkatëse komunale.

**Me këtë Vendim njoftohen:**

1. Kryetari i Komunës;
2. Drejtoritë Komunale: dhe
3. Arkiva.



Kryesuesi i Kuvendit  
Kemal Mërseli